

Shënim: Kjo përgjigje lidhet vetëm me pikat e kërkuara për plotësim nga FSDKSH:

Ne Listën e Barnave të Rimbursuara, të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 489, datë 30.07.2021, "Për miratimin e Listës së barnave, që rimbursohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, dhe të masës së mbulimit të çmimit të tyre", barnat që jepen ne Fibroze Kistike (MUKOVISCIDOZE) janë:

Multienzimes (L+A+P), Pancreatin 10.000 Nj.N dhe Multienzimes (L+A+P) Pancreatin 25.000Nj.N

Kufizimi për këto barna është: "Në Mukoviscidozë, Pankreatit Kronik dhe pas Pankreatoktomisë. Me konsultë të shërbimit të Gastro-Hepatologjisë në QSUT."

Për përfitimin e barnave me rimbursim nga Lista e Barnave të Rimbursueshme, pacientët duhet të drejtohen të Qendra Shëndetësore, pranë mjekut të familjes, i cili do t'i referojë për trajtimin e sëmundjes.